



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 52

Prishtinë, më 19.02.2016, në orën 18:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Selville Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Albulena Haxhiu, Donika Kadaj -Bujupi dhe Valdete Bajrami.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Nuk kishte.

Nga stafi i Komisionit: Visar Krasniqi dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi, Selville Halimi, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-092 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-068;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-092 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-068

Kryesuesja – Në fjalën e saj hyrëse tha se ne është dashur që takohemi me shpejtësi që të shqyrtojmë raportin me amendamente të Komisionit për Buxhet dhe Financa, që ka të bëjë me projektligjin për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës. Ju përkujtoj se ne në fillim të seancës votuam për shmangie të Rregullores që të shkojë ky projektligj me procedurë të përshpejtuar. Përpara vetes kemi raportin me rekomandime dhe hap debat rreth këtyre amendamenteve që kanë ardhur nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Armend Zemaj- Në fjalën e tij tha se meqë ky Projektligj është i një rëndësie të veçantë, unë kam menduar që do të hartohet një ligj i ri që do t'i ndihmonte procedurës. Por meqë jemi në një fazë të tillë tha se e përkrah procedimin e mëtejshëm të Projektligjit.

Meqë nuk kishte diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se komisioni në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-42 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe nr.05/L-068, me amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

3. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë pikë për diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 18:05.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Nënkryetarja e Komisionit,

Selvije Halimi